



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Nr/Br. 03/17
Date/Datum. 23.02.2017



PRIŠTINA - PRISTINA
Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY**

PSH Nr. 03/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Nuhi Paçarizi - Kryetar, z.Tefik Sylejmani - Referues, z.Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues Ntsh “Ekoinvest” - Prishtinë, kundër AK-/Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërrimi i sistemit gypor në hinkën e vatrës së kaldajës së bllokut A3”, me nr prok:“16/113/511”, më datën 09.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

- I. **Hedhet**, poshtë si e pa lejuar ankesa e OE Ntsh Ekoinvest” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërrimi i sistemit gypor në hinkën e vatrës së kaldajës së bllokut A3”, me nr prok:“16/113/511”, iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/ (KEK).
- II. **Aprovohet**, vendimi i AK-së /Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/, për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërrimi i sistemit gypor në hinkën e vatrës së kaldajës së bllokut A3”, me nr prok:“16/113/511”.
- III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarrja lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.
- IV. Operatorit ekonomik ankues OE “Ntsh Ekoinvest” - Prishtinë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është hedhur poshtë si e pa lejuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë është bërë me dt: 23.02.2016, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt:04.04.2016, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë tre operatorë ekonomik.

Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:01.11.2016, me arsyetimin e mungesës së fondeve.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik “Ntsh Ekoinvest” - Prishtinë është bërë me dt:21.12.2016.

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është marr me dt:27.12.2016

I pakënaqur me vendimin për refuzim të kërkesë për rishqyrtim operatori ekonomik “Ntsh Ekoinvest” - Prishtinë, ka deponuar ankesë në OSHP, më 06 janar 2017 me nr. 03/17, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërrimi i sistemit gypor në hinkën e vatrës së kaldajës së bllokut A3”, me nr prok:“16/113/511”, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 8 i UOPP-së
- Neni 22 i LPP-së (Inicimi i aktivitetit të prokurimit)
- Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Organi Shqyrtares i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik përmes raportit të datës 24 janar 2017, bazuar ne sqarimet e cekura në raport ka rekomanduar panelin shqyrtues që aktiviteti i prokurimit me titull: “Ndërrimi i sistemit gypor në hinkën e vatrës së kaldajës së bllokut A3”, me nr prok:“16/113/511”, të kthehet në Rivlerësim, ndërsa ankesa e OE “Ntsh Ekoinvest” – Prishtinë të aprovohet si e bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Ntsh Ekoinvest” - Prishtinë, me datë: 31 janar 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 09.02.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues/teknik, përfaqësuesit e palëve në procedurë, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i iniciit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues “Ekoinvest”, ka deklaruar: “Ashtu si kanë vërtetuar ekspertët shkeljet e AK-së për nenin 22 dhe 62 të LPP jemi pajtuar me këtë mendim të ekspertëve. Duam ti kujtojmë panelit vendimin e datës 25.07.2016 nr.191/16 të OSHP-së, ku ka qenë rasti ngjashëm sa i përket anulimit të aktivitetit të prokurimit, dhe kërkojmë që ky rast të trajtohet si rast i gjykuar. Ky aktivitet prokurimit ka filluar në Shkurt të vitit 2016, dhe është një vit në procedurë për këtë projekt dhe ekziston vendimi i OSHP i urdhrit të prerë që AK-KEK nuk e ka respektuar fare.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-“KEK”, ka deklaruar: “Njësia kërkuese e AK-së nuk ka paraparë në buxhetin e vitit 2017 mjete financiare për këtë aktivitet të prokurimit, prandaj informatat financiare në deklaratën e nevojave dhe disponueshmërinë e mjeteve të bërë në fillim të këtij aktivitetit të prokurimit kanë ndryshuar në mënyrë substanciale. AK-KEK për këtë arsyе gjithnjë duke u bazuar në LPP dhe UOPP ka bërë anulimin e këtij aktivitetit të prokurimit. Në LPP neni 26 par.4.2 dhe UOPP par.8.7 thuhet “personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratën janë të obliguar para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës të rikonfirmojnë që informatat financiare në deklaratën e nevojave dhe disponueshmërinë e fondeve nuk janë ndryshuar në mënyrë substanciale”. Vazhdimi i këtij aktivitetit pa mjete financiare do ishte në kundërshtim të plotë me nenet e cekura të LPP dhe UOPP-së. Andaj gjithnjë duke u bazuar në LPP dhe UOPP i propozoj panelit që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AK-së për anulimin e këtij aktivitetit.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues i OSHP-së, ka deklaruar: “Sqaroj që ky proces i prokurimit është i përshkruar në raportin e ekspertizës kundrejt pretendimeve ankimore, me gjithë atë sqaroj pse kemi rekomanduar rivlerësim është se në shkresat e AK-së në shkresa të lëndës, në informata financiare, deklarata e mjeteve në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit, ku në të njëjtën deklaratë është parashikuar vlera prej 600.000 €. Ankuesi sipas raportit të hapjes e ka çmimin më të ulët se vlera e parashikuar, rreth 400.000 €, dhe për këtë arsyë kemi rekomanduar që lënda atë kthehet në Rivlerësim.

Gjatë seancës anëtari i panelit shqyrtues z. Sylejmani pyeti përfaqësuesin e AK-së se nga koha e marrjes së vendimit të parë të OSHP-së për Rivlerësim, sa kohë ka kaluar deri tek rivlerësimi i ofertave, ku keni qenë të obliguar që në afat prej 10 ditë të njoftoni panelin shqyrtues për veprimet e ndërmarra nga AK dhe pse nuk është anuluar atëherë për këtë qëllim ky aktivitet, për mungesë të mjeteve?

Në përgjigje përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: "Anulimi i parë është bërë brenda afateve ligjore, pas dërgimit të eliminimit të OE ka bërë kërkesë për rishqyrtim, e cila ka marrë kohë. Ndërkohë është parashtruar ankesë pranë OSHP-së dhe OSHP konfrom afateve të veta ka shqyrtuar lëndën dhe ka kthyer në Rivlerësim. Konform vendimit të OSHP-së autoriteti ka formuar komisionin për rivlerësim, dhe ky komision ka gjet konstatimet e njëjtë si komisioni i parë sepse OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes nga aspekti teknik. Është dërguar njoftimi për anulim, OE ankues ka bërë kërkesë pranë AK për rishqyrtim dhe AK ka shqyrtuar kërkesën dhe me vendim ka trajtuar pjesërisht të bazuar dhe ka kthyer lëndën në rivlerësim, dhe gjithë këta hapa marrin kohë për shqyrtimin e lëndës. Njofoj panelin se komisioni i rivlerësimit prapë e ka shpall të papërgjegjshëm për dy arsyet, dhe arsyet tjetër ka qenë se mjetet financiare për vitin 2017 për këtë aktivitet AK nuk ka planifikuar. Arsyet për anulimin e aktivitetin dhe e dyta është mungesa e mjeteve.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar: "Duhet të qartësoj se vendimin e OSHP për rivlerësim, kanë kaluar 115 për rivlerësim nga AK. Me 31.10.2016 përsëri njoftohemë për tenderuesin e pasuksesshëm me pretendimet e njëjtë si në eliminimin e parë. Kundër këtij vendimi me kemi bërë kërkesë për rishqyrtim dhe thjeshtë kemi thënë "Respektoni vendimin e OSHP-së". I kërkojmë panelit shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë e bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-KEK ka deklaruar: "AK nuk ka mjetet financiare për të zhvilluar këtë projekt më tutje dhe kërkojmë të mbetet në fuqi vendimi i AK-së si i bazuar.

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues ka deklaruar: Qëndroj pranë raportit të ekspertizës së datës 27.01.2017.

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, ekspertizës së ekspertit shqyrtues, si dhe gjatë deklaratave të dhëna në seancën dëgimore, konstaton është i paqëndrueshëm pretendimi i OE ankues se kjo është çështje e gjykuar përfakt se në herën e parë anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në mungesë të ofertave të përgjegjshme dhe pretendimi ankimor ka qenë përfkuptues që këtë pikë ndërsa tanë më autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin e mungesës së mjeteve financiare dhe pretendimi ankimor tashmë ka të bëjë me këtë çështje. Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit duke u bazuar në nenin 26 të LPP-së ku shkruan "Personat e autorizuar që të nënshkruajnë sipas paragrafit 1. dhe 2. ose 3. të këtij neni mund të nënshkruajnë kontratën e tillë vetëm nëse përbushen kushtet vijuese: ndërsa në paragrin 4.2 të këtij neni shkruan "Personat kanë konfirmuar edhe një here se informatat që gjinden në "Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve" janë ende të sakta", prandaj në mungesë të

konfirmimit siç parashihet në nenin e lartpërmendor dhe me rastin e ndryshimeve substanciale në mungesë të mjeteve financiare konform nenit të lartpërmendor të LPP-së, atëherë rezulton se autoriteti kontraktues ligjërisht e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit. Këtë fakt e parasheh edhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik konkretisht neni 8.7 ku shkruan që “*Personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratat janë të obliguar, para publikimit te njoftimit për dhënie të kontratës, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale*” ndërsa në këtë rast ka ndodhur ky ndryshim në mënyrë substanciale pasi që autoriteti nuk ka mjete financiare të parashikuar për vitin 2017 për këtë projekt, përderisa ky aktivitet i Prokurimi është zgjatur pothuajse një vit nga momenti i njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues “Ntsh Ekoinvest” me rastin e parashtimit të ankesës nuk ka mundur të dëshmojë dhe të argumentojë se ka interes juridiko material konform nenit 111 paragrafi 1.5 dhe 1.8 përkitazi me nenin 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, pasi që në asnjë variant OE ankues nuk ka mundur të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënöhët t’i shkaktojë dëme materiale dhe se në mungesë të mjeteve financiare të autoritetit kontraktues ky operator ekonomik në asnjë rrëthanë nuk mund të shpallet fitues i këtij tenderi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK – “Korporata Energetike e Kosovës”

1x1 OE – “Ntsh Ekoinvest” - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.